



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Nr.i Ref. 45/2023

Bazuar në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Konkursit Publik me nr.ref ADM 29/2023 i shpallur me datë 29.03.2023, për pozitën e punës **Sekretar/e i/e Përgjithshëm i OMK-së** me kohë të caktuar në Odën e Mjekëve të Kosovës me seli në Prishtinë, si dhe Vendimit me nr ref ZK 173/2023 i datës 31.03. 2023 si dhe Vendimit me nr ref ZK 176/2023 i datës 18.04.2023 Komisioni për Vlerësim dhe Përzgjedhje, në përbërje të: Dr. Naser Gjonbalaj –Kryetar i Komisionit, Dr. Rrezart Halili - anëtar dhe Dr. Lauras Idrizi –anëtar, në mbledhjen e mbajtur me 24 prill 2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. **ANULOHET** Konkursi Publik me nr.ref ADM 29/2023 i shpallur me datë 29.03.2023, për pozitën e punës **Sekretar/e i/e Përgjithshëm i OMK-së**, si rezultat i dështimit të dorëzimit të aplikacioneve për punësim në pozitën e cekur nga palët e interesuara.
- II. **Komisioni rekomandon** përsëritjen e Konkursit Publik sipas parag I të këtij Vendimi, në afat prej 8 ditësh nga shpallja e njoftimit për anulimin e të njejtit.
- III. **Obligohet** Zyra për Administratë e OMK-së, që sipas paragrafit I të këtij Vendimi të kryejë procedimin dhe administrimin sipas procedurave të përcaktuara ligjore, duke bërë shpalljen e njoftimit për anulimin e konkursit publik.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## *Arsyetim*

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve për Konkursin Publik me nr.ref ADM 29/2023 i shpallur me datë 29.03.2023, për pozitën e punës **Sekretar/e i/e Përgjithshëm i OMK-së**, përkatësisht pas mbylljes së afatit me datë 13 prill 2023 ora 16:00, zyra për administratë e OMK-së e ka njoftuar Komisionin për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e kandidatëve se për pozitën e punës si më lartë nuk ka pranuar asnjë aplikacion. Komisioni për Vlerësim dhe Përzgjedhje, ka mbajtur takim me datë 24 prill 2023 dhe konform Nenit 6 paragrafi 5 me nënparagrafin 5.1., të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, ka konstatuar se në këtë fazë të procesit të rekrutimit nuk është plotësuar kushti themelor që të ketë së paku tre aplikues që i plotësojnë kriteret për pozitën e lire të punës, dhe me votim unanim ka vendosur për anulimin e konkursit publik me nr ref ADM 29/2023 i dt 29.03.2023. Poashtu, Komisioni Vlerësim dhe Përzgjedhje konform Nenit 6 paragrafit 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, ***i rekomandon*** Kryetarit të OMK-së që në afat prej 8 ditësh nga shpallja e njoftimit për anulimin e konkursit, të nxjerrë vendim për përsëritjen e konkursit publik dhe të njëjtin ta publikojë në njërën nga mjetet e shkruara të informimit.

Andaj, **Komisioni për Vlerësim dhe Përzgjedhje**, në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë e parapara ligjore, përkatësisht konform Nenit 6 paragrafi 5 me nënparagrafin 5.1., dhe paragrafit 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

***Këshilla juridike:*** Palët e pakënaqura me këtë Vendim, mund të bëjnë ankesë brenda afatit prej tetë (8) ditësh në Komisionin e Ankesave pranë OMK-së.

Dr. Naser Gjonbalaj - Kryetar i Komisionit

24 prill 2023, Prishtinë

